

Vlerat natyrore

Flora dhe fauna e Parkut nacional „Malet e Sharrit“

Parku Nacional „Malet e Sharrit“ është i pasur me resurse të rralla natyrore të cilët kanë vlera të posaçme shkencore, edukativo-arsimore, rekreative, sportive-turistike dhe estetike. Në kuadër të vlerave natyrore veçohet shumëllojshmëria (biodiverziteti) i florës dhe faunës.

Ky Park nacional posedon:

- 2500 lloje të bimëve
- 112 asociacione të vegjetacioneve pyjore, shkurre dhe barishtore
- 165 lloje të shtazëve të egra
- 200 lloje të shpendëve
- 147 lloje të fluturave

Bota bimore (flora)

Në kuadër të florës së pasur me afro 2500 lloje të bimëve veçohen 323 bimë endemike që këtë territor e bënë unikat në Ballkan, ndoshta edhe në Europë. Llojet më të rëndësishme drunore janë endemoreliktet rrobulli (*Pinus heldreichii*) dhe arneni (*Pinus peuce*), ndërsa vlerë të veçantë kanë 20 lloje të bimëve stenoendemike: barpezmi i Aleksandrit (*Achillea alexandris regis*), bornmulera e Dieckit (*Bornmullera dieckii*), cerasti i Sharrit (*Cerastium neoscardicum*), karafil i Sharrit (*Dinathus scardicus*); draba e korabit (*Draba korabensis*); potentila e Doerflerit (*Potentilla doerfleri*); krokusi i Sharrit (*Crocus scardicus*); bar peshku i Sharrit (*Verbascum scardicum*), kokëz e Shmukerit (*Silene schmucheri*), këmaskna e Kobilicës (*Hieraceum kobilicanum*), këmaskna e Lubotenit (*Hieraceum naegelianum supss. Lubotenicum*), rrushqyqe (*Sedum flexuosum*), etj.

Vegjetacioni

Vegjetacioni i Parkut nacional është i pasur me bashkësi (asociacione) të ndryshme pyjore, shkurre dhe barishtore. Deri më tani janë identifikuar 112 asociacione, në kuadër të cilëve rëndësi të veçantë kanë ato të karakterit endemo-relikt të rrobullit, arnenit dhe bimëve stenoendemike.

Në aspektin vertikal veçohen këto vegjetacione kryesore:

1) Brezi i pyjeve të dushkut (*Quercetum montanum*) dhe pyjeve të përziara të mullezës dhe frashnit të zi (*Orno Ostryetum carpinifoliae*)

Në këtë brez pyjor dominojnë llojet: bungu (*Quercus petrea*), frashni i zi (*Fraxinus ornus*), mullëza (*Ostrya carpinifolia*), qarri (*Quercus cerris*) dhe shkoza e bardhë (*Carpinus betulus*). Ky vegjetacion pyjor kryesisht gjendet në pjesët më të ulëta në ekspozicionin jugor të Oshlakut dhe Rusenicës.

2) Brezi mezofil i pyjeve të ahut (*Faginion mosaicae*).

Ky brez nga aspekti i sipërfaqeve pyjore dominon në Parkun nacional dhe paraqitet në dy grupe asociacionesh dhe atë: bashkësia kodrinore e ahut (*Fagetum montanum*) dhe bashkësia e bredhit dhe ahut (*Abieto-Fagetum*), ndërkaq në viset më të larta në kuadër të kësaj bashkësie paraqitet hormoqi (*Picea excelsa*). Bashkësitë e ahut janë të zhvilluara kryesisht në ekspozicionet veriore, në lartësitë mbidetare ndërmjet 900 – 1600 m.

1) Brezi i pyjeve të halorëve

rrobullit dhe arnenit (Pinetum heldreichii dhe Pinetum peucis)

Ky brez kryesisht përbëhet prej bashkësive endemike të pishave malore endemorelikte të rrobullit (Pinus heldreichii) dhe arnenit (Pinus peuce) të cilët shtrihen në lartësinë mbidetare prej 1500-1900 m. Bashkësitë më të ruajtura të rrobullit janë në Koxha Ballkan, Oshlak, Prevallë, Pashallarë (Ostrovicë) dhe në Ujërat e Humbur (Gine Vode), ndërsa bashkësitë më të ruajtura të arnenit gjenden në Ujërat e Humbur dhe të Prrocka e Durlës. Këto pyje janë më të rëndësishme në Parkun nacional nga të cilët një pjesë e vogël janë shpallur si rezervate strikte natyrore, ndërsa në të ardhmen planifikohet që shumica e sipërfaqeve të këtyre pyjeve të shpallën si rezervate.

4) Brezi shkurre i dredhakut (Pinetum mughi) dhe llojeve të tjera shkurre.

Bashkësitë e dredhakut (Pinus mugo) gjenden në Koxha Ballkan, Oshlak dhe Pashallarë (Ostrovicë). Në pjesët ku nuk është e pranishme hartina, janë prezentë llojet e tjera shkurre: dellinja e siberisë (Juniperus nana), boronica (Vaccinium myrtillus), trëndafili alpink (Rododendron ferugineum), Bruckenthalia specidifolia, Erica carnea etj.

5) Vegjetacioni barishtor i maleve të larta

Livadhet dhe kullosat malore dhe maleve të larta janë të pasura me bashkësi të rëndësishme bimore. Në kullosat e larta malore dominojnë bashkësitë e bar malit (Nardus stricta), ndërsa në lartësitë më të mëdha mbidetare dominojnë elementet e florës arktoalpike.

Bota shtazore (fauna)

Parku nacional „Mali Sharr“ është i pasur me lloje të shumta të shtazëve ku, sipas studimeve që janë bërë, jetojnë afro 165 lloje, nga të cilët një numër i tyre janë endemike dhe të pranishme vetëm në disa zona tejet të kufizuara të Parkut, siç është rasti me rrëqebullin (Lynx lynx). Klaset e shtazëve të cilët veçohen në Parkun nacional janë: Peshqit (Pisces), Ujëtokësorët (Amphibia), Rreshqitësit (Reptilia), Shpendët (Aves), Gjitarët (Mamalia) etj.

Gjitaret (Mamalia)

Llojet më të rëndësishme të shtazëve të egra janë: reqebulli (Lynx lynx), shqarthe i artë (Martes martes), lundërza (Lutra lutra), ariu i murrmë (Ursus arctos), kaprolli (Capreolus capreolus), dhia e egër (Rupicapra rupicapra), ujku (Canis lupus), dhelpër (Canis vulpes), derri i egër (Sus scrofa), vjedulla (Meles meles), macja e egër (Felis sylvestris), fishnjari (Martes fionna), Dinaromys bogdanovi, etj.

Shpendët (Aves)

Shpendët në Parkun nacional paraqiten në të gjitha biotopet, ku jetojnë mbi 200 lloje, kurse numri i llojeve dhe populacioneve të tyre i tejkalon të gjitha klasat e tjera të faunës përpos insekteve. Llojet më të rëndësishme janë: pulegra e madhe (Tetrao urogalus), borsi i borës (Montifringilla nivalis), shqiponja kryqezare (Aquila heliaca), shqiponja e përhimët (Aquila chrysaetos), shqiponja e maleve (Hieraaetus fasciatus), vulturida (Gyps fulvus), huti i madh (Bubo bubo), skifteri i përhimët (Falco peregrinus), skifteri malor (Falco biarmicus), pula e pyjeve (Tetrastea bonasia), fëllënza e gurëve (Alectoris graeca), petriti i pulave (Accipiter gentilis), Gypaetus barbatus, dallandysheja e natës (Caprimulgus europaeus), lauresha e pyjeve (Lullula arborea), etj.

Insektet-fluturat

Insektet në aspektin e numrit dhe shumëllojshmërisë janë dominues në Parkun nacional. Në kuadër të tyre, në veçanti, janë hulumtuar fluturat nga të cilët deri më tani janë identifikuar 147 lloje. Mund të konstatohet se në aspektin e shumëllojshmërisë së fluturave, midis të cilëve ka edhe lloje endemike, Parku nacional „Mali Sharr“ është i pakrahasueshëm në Ballkan, ndoshta edhe në Europë.

Vlerat e tjera natyrore

Parku nacional, përveç specifikave të veçanta të florës dhe faunës, karakterizohet edhe me veçori të posaçme gjeomorfologjike, gjeologjike, peisazhore, klimatike dhe hidrologjike që këtë territor e bëjnë tejet interesant dhe të veçantë në gadishullin Ballkanik dhe kontinentin European.

Zonat e veçanta

Në Parkun nacional, për momentin gjenden katër rezervate strikte natyrore:

- Rrobulli (KK Prizren) - Rezervati strikt natyror i pyjeve të rrobullit (Seslerio-Pinetum heldreichii) në shpatet jugore të Oshlakut, në rajonin e Prevallës, me sipërfaqe prej 30 ha.
- Oshlak (KK Prizren) - Rezervati strikt natyror i pyjeve të rrobullit (Pinetum heldreichii) në shpatijet juglindore të Oshlakut, me sipërfaqe prej 20 ha.
- Pisha e Madhe (KK Prizren) - Rezervati strikt natyror i pyjeve të vjetra të rrobullit (Seslerio-Pinetum heldreichii) në ekspozicionin juglindor të Koxha Ballkanit me sipërfaqe prej 35 ha.
- Rusenica (KK Suharekë) - Rezervati strikt natyror - vendbanimi i rreqebullit (Lynx lynx) në Grykën e Rusenicës me sipërfaqe prej 300 ha.

Në të ardhmen planifikohet zgjerimi i sipërfaqeve të rezervateve ekzistuese dhe shpallja edhe 10 rezervateve të reja strikte të natyrës, ashtu që si zona të I të mbrojtjes (rezervate strikte të natyrës) janë propozuar 14 zona me sipërfaqe prej 4118 ha. Rezervatet e propozuara janë:

1) Luboteni (KK Kaçanik) - 201 ha

Luboteni paraqet zonën e maleve të larta (2499 m) në gëlqeror e mbuluar me vegjetacione barishtore të pasura me bimë endemike të cilët formojnë bashkësi (fitocenoza) të rralla bimore të karakterit subalpin dhe alpin. Ndër bashkësitë më të rëndësishme veçohet Carex laevis-Helianthemum, në kuadër të cilës gjenden relikte glaciale Dryas octopetala, Linaria alpina, Sideritis scardica, Hieracium naegelianum supss. Lubotenicum, etj.

2) Livadhishte (KK Shtërpçë) - 134 ha

Rezervati i propozuar natyror „Livadhishte“ paraqet zonën e maleve të larta në silikat ku gjenden liqeni glacial (2173 m) më i madhi në Parkun nacional (gjatësia 230 m, gjerësia 120 m dhe thellësia 7 m) dhe ekosistemet barishtore të pasura me bimë endemo-relikte të cilët formojnë bashkësi të rralla bimore. Nga bimët e shumta endemike veçohen: karafil i Sharrit (Dianthus scardicus - st. end.); potentila e Doerflerit (Potentilla doerfleri - st. end.); krokusi i Sharrit (Crocus scardicus - st. end.); drabë e Korabit (Draba korabensis - st. end.); kriptogramë kaqurrele (Cryptogramma crispa); etj.

2) Prrocka e Durlës (KK Shtërpçë) - 273 ha

Kjo zonë ka rëndësi të veçantë gjeomorfologjike dhe floristike. Karakteristikat kryesore të zonës janë bashkësitë e rralla të panjës malore dhe ahut (*Acero heldreichii*-Fagetum moesiaceae), trendafilin alpin dhe arnenit (*Rhododendro-Pinetum peucis*), dëllinjës së siberisë dhe brukentalisë (*Juniperus nana*-*Bruckenthalia spiculifolia*) si dhe flora e pasur endemike, ndër të cilët veçohen: potentillë e Doerflerit (*Potentilla doerfleri* - st. end.); drabë e Korabit (*Draba korabensis* - st. end.); *Sedum flexuosum* (st. end.); *azulea* alpike (*Loiseleuria procumbens*), nartecë e Sharrit (*Narthecium scardicum*); selaginella si selaginellë (*Selaginella selaginoides*); tozia alpine (*Tozzia alpina*); zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*) etj.

3) Bistra (KK Shtërpçë / KK Prizren) - 975 ha

Kjo zonë karakterizohet me vlera të veçanta floristike, faunistike, fitocenologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike dhe hidrologjike. Emri i rezervatit natyror është dhënë në bazë të majës malore Bistra (2651 m) e cila paraqet majën më të lartë në Parkun nacional dhe të dytën në Republikën e Kosovës, pas Gjeravicës (2671 m). Specifikat më të rëndësishme të zonës janë bashkësitë pyjore të rrobullit, arnenit, pishës së bardhë, hormoqit, panjës malore, ahut, rododendrës, bashkësitë shkurre dhe barishtore të maleve të larta në silikate, liqeni akullnor i Jazhincës (gjatësia 120 m, gjerësia 90 m dhe thellësia 11 m) etj.

Zona e Bistrës, përveç me llojet e rralla drunore, veçohet edhe me shumëllojshmërinë e bimëve endemike barishtore, nga të cilët më të rëndësishme janë: drabë e Korabit (*Draba korabensis* -st. end.); potentillë e Doerflerit (*Potentilla doerfleri* - st. end.); karafil i Sharrit (*Dianthus scardicus* - st. end.); karafil me balluke (*Dianthus superbus*); fiteumë jo e qartë (*Phyteuma confusium*); nartecë e Sharrit (*Narthecium scardicum*); zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*); etj.

Zona është e pasur edhe me lloje të shumta të faunës (kafshëve të egra dhe shpendëve), në kuadër të cilëve veçohen: dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), macja e egër (*Felis sylvestris*), vjedulla (*Meles meles*), pulegra e madhe (*Tetrao urogallus*), shqiponja e përhimët (*Aquila chrysaetos*), shqiponja minjngrënëse (*Buteo buteo*), huti pyjor (*Bubo bubo*) etj.

4) Lumbardhi (KK Prizren) - 301 ha

Ky rezervat natyror karakterizohet me vlera të posaçme biologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peisazhore. Zona paraqet cirkun silikat akullnor të maleve të larta ku gjenden: burimi dhe ujërrjedhja e epërme e Lumbardhit të Prizrenit, dy liqej glacial (Liqeni i Madh dhe i Vogël i Katundit të Epërm) dhe ekosistemet përcjellëse të pasura me bimë endemike, në kuadër të cilëve veçohen: karafil i Sharrit (*Dianthus scardicus* - st. end.); draba e Korabit (*Draba korabensis* - st. end.); potentillë malazeze (*Potentilla montonegrina*); herakle e Orfanidhit (*Heracleum orphanidis*); pedikulare e Oederit (*Pedicularis oederi*); kokëz e Valdshtainit (*Silene waldsteinii*); kryptogramë kaqurrele (*Cryptogramma crista*); zhabina (*Ranunculus incomparabilis*) etj. Pjesa më të larta shkëmbore e zonës është habitat i dhive të egra dhe shpendëve grabitqarë, në veçanti të shqiponjës së përhimtë (*Aquila chrysaetos*).

5) Dupnicë (KK Prizren) - 489 ha

Dupnica është zonë e maleve të larta e dominuar me shkëmbij silikat dhe vegjetacion barishtor që paraqesin habitat i dhive të egra dhe bimëve endemike, ndër të cilët veçohen: klokëz Shmukeri (*Silene schmucheri* - st. end.), shelgu barishtor (*Salix herbacea*), karafil me balluke (*Dianthus superbus*) etj. Zona është interesante edhe nga aspekti gjeomorfologjik dhe peisazhor.

6) Kopilicë (Kobilica) (KK Prizren) - 196 ha

Kopilica paraqet zonën gëlqerore të malit të lartë (2528 m) me bimë të rrallë kalcifite dhe hezmofite që janë të përshtatur habitatit me kushte të vështira klimatike dhe pedologjike (tokat e varfra dhe pa zhvilluara). Bimët më të rëndësishme endemike të zonës janë: *Hieracium kobilicanum* (st. end.); kokëz e Shmukerit (*Silene schmucheri* - st. end.); lëpjetë bore (*Rumex nivalis*); shelgu barishtor (*Salix herbacea*); karafil me balluke (*Dianthus superbus*); manushaqe e Grisebahut (*Viola grisebachiana*); erigeron (*Erigeron uniflorus*); saussurea alpine (*Saussurea alpine*); zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*). Kopilica së bashku me Lubotenin paraqesin zonat e vetme gëlqerore në malin Sharr i cili është i dominuar nga sendimenti silikat.

7) Gryka (Klisura) (KK Shtërpçë) - 114 ha

Zona e Grykës (Klisurës) karakterizohet me bashkësinë autoktone të reliktit terciar tisit (*Taxus baccata*) me ahun (*Fagus mosaicae*) Fageto - Taxetum baccata e cila shtrihet në lokalitetin Pulan (Kokoshinje). Tisi është lloji i vetëm halor në vendin tonë që zhvillohet, përveç mënyrës gjenerative (me fara), edhe në mënyrë vegjetative. Areali i përhapjes së tij është mjaftë i kufizuar dhe mund të thuhet së ku lloj është i rrezikuar për zhdukje. Rëndësi të veçantë këtij rajoni i jep edhe prania e llojit endemorelikt ramonda e Natalisë (*Ramonda nathaliae*).

8) Rrobulli (KK Prizren/KK Shtërpçë) - 145 ha

Zona e Rrobullit është e pasur me pyje të llojit endemo-relikt të rrobullit (*Pinus heldreichii*) i cili në shpatijet jugore gëlqerore të Oshlakut formon bashkësinë Seslerio-Pinetum heldreichii, ndërsa në shpatijet jug-lindore, që kanë më shumë lagështi, formon bashkësinë *Luzulo maximae*-Pinetum heldreichii. Në pjesën lindore të zonës, nën pyjet e rrobullit, gjendet bashkësia pyjore e ahut *Fagetum montanum*. Zona e Rrobullit është e pasur me bimë endemike, nga të cilët veçohen: bar peshku i Sharrit (*Verbascum scardicum* - st. end.), gencianëza bullgare (*Gentianella bulgarica* var. *Albanica*), karafil i kartusianve (*Dianthus cartusianus*), karafil shkëmbinjësh (*Dianthus integer*), lulekambane shqiptare (*Campanula albanica*), lisra shqiptare (*Thymus albanus*), epsparseta e Sharrit (*Onobrychis scardica*), sarushta e Sharrit (*Stachys scardica*), manushaqja e Zoisit (*Viola zoisii*), etj.

Zona është e pasur edhe me lloje të shumta të kafshëve të egra (mamalia) dhe shpendëve (ornitofauna). Llojet më të rëndësishme të kafshëve janë: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*) etj.

Shpendët më të rëndësishme janë: shqiponja e përhimtë (*Aquila chrysaetos*), shqiponja minjngrënëse (*Buteo buteo*), skifteri malor (*Falco biarmicus*), pula e pyjeve (*Tetrastes bonasia*), thëllëzës së gurit (*Alectoris graeca*), borsi i borës (*Montifringilla nivalis*), stërqoka (*Pyrrhocorax pyrrhocorax*) etj.

9) Oshlak (KK Prizren/KK Shtërpçë) - 550 ha

Oshlaku është zonë e malit të lartë në gelqëror me pyje të rrobullit, pyje të pastra të hormoqit, bashkësitë e dredhakut dhe bimët e shumta endemike. Simboli i veçantë i Oshlakut është lloji lokal endemik i vjetërsisë glaciale *Achillea alexandri regis* që gjendet kryesisht në pjesët më të larta ku me llojin tjetër endemik të Ballkanit qëndror *Onobrychis scardica* formon bashkësinë specifike e malit të lartë *Achilleo alexandri regis-Onobrychis scardica*. Nga llojet e tjera të shumta endemike veçohen: heliantema e thinjur (*Helianthemum canum*), karafili i Sharrit (*Dianthus scardicus*), karafili i gurit (*Dianthus integer*), shmanga shqiptare (*Crepis albanica*), lisra shqiptare (*Thymus albanus*), edrianti gjethebari (*Edreianthus graminifolia*), brinjëkau i Karglit (*Bupleurum karglii*), alkana e Sharrit (*Alcanas scardica*), asteri alpin (*Aster alpinus*), etj.

Zona është e pasur edhe me lloje të shumta të kafshëve të egra (mamalia) dhe shpendëve (ornitofauna). Lloji më i rëndësishëm i zonës është dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*).

10) Pisha e Madhe (KK Prizren) - 45 ha

Pisha e Madhe karakterizohet me pyjet e vjetra të rrobullit të bashkësisë *Seslerio-Pinetum heldreichii*, të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të rrobullit në Ballkan. Zona e rezervatit i përfshinë sipërfaqet e pyjeve të ruajtura të rrobullit në pjesët lindore të kompleksit Pisha e Madhe. Zona është e pasur me lloje të shumta të florës të cilët kryesisht janë kosmopolite, ndërsa vlerë të veçantë kanë lloji endemik *Sedum flexiosum* dhe llojet me karakter mjekues, siç janë: ushojza pakërçell (*Carlina acaulis*), genciane e kryqëzuar (*Gentiana cruciata*), bari i ethes (*Centaurium erytrea*), rigoni i zakonshëm (*Origanum vulgare*), trëndafili shajakor (*Rosa tomentosa*), etj.

Pisha e Madhe paraqet habitat i llojeve të shumta të kafshëve të egra, ndërsa lloji më i rëndësishëm është ariu i murrmë (*Ursus arctos*).

11) Rusenicë (KK Suharekë) - 270 ha

Rusenica është zonë malore me shkëmbintë gelqëror dhe pyje të ahut (*Abieti-Fagetum*) që janë habitat të rregebullit ballkanik (*Lynx Lynx balcanicus*). Me qëllim të mbrojtjes së këtij lloji të rrezikuar në vitin 1955 Rusenica është shpallur si zonë strikte e natyrës. Zona është e pasur edhe me bimë të shumta endemike, siç janë: bornmullera e Dieckit (*Bornmullera dieckii* - st.end.), rrobulli (*Pinus heldreichii*), panja malore (*Acer heldreichii*), potentila argjentë (*Potentilla argentea*), poligalla e Doerflerit (*Pilygala doerfleri*), barpezmi gjethemëndafsh (*Achillea holysolicea*), këmashna e Valdshtajnit (*Hieraceum weldsteini*), ngjitësja e shkëmbit (*Galium rupestre*), xerxolja si ulli (*Daphne oleoides*), sarushta boshnjake (*Scrophularia bosniaca*), minuarca e Baldacit (*Minuartia baldacii*), etj.

12) Pashallare (KK Suharekë / KK Shtërpçë) - 411 ha

Pashallare paraqet zonën e malit të lartë në serpentinit me pyje të pastra të rrobullit, pyjet e përziera të rrobullit dhe arnenit, pyjet e ahut, bashkësitë e dredhakut dhe shkëmbintë serpentinite me lloje të rralla endemike të florës. Bashkësitë e rrobullit dhe dredhakut në serpentinit të Pashallarës paraqesin fenomen të veçantë natyror në vegjetacionin e Ballkanit.

Vlerë të posaçme zonës i japin llojet e shumta endemike: bornmulera e Dieckit (*Bornmullera dieckii* - st. end.), cerasti i Sharrit (*Cerastium neoscardicum* - st.end.), grurëzi i Sharrit (*Melanpyrum scardicum*), zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*), lulekambanë shqiptare (*Campanula albanica*), karaboti i shkëmbit (*Carum rupestre* var. *Albanicum*), kokizë e

vockël (*Silene pusila* var. *Albanica*), sarushë e Sharrit (*Stachys scardica*), sericë e Sharrit (*Alysum scardicum*), lulekambana shqiptare (*Campanula albanica*), knaucia dinarike (*Cnautia dinarica*), manushaqe e Grisebahut (*Viola grisebachii*), rrushqyqe serpentine (*Sedum serpentine*), karafil i hajthëm (*Dianthus gracilis*), njëgjira e Doerflerit (*Asperula doerfleri*), etj.

Zona është e pasur edhe me lloje të shumta të kafshëve të egra dhe shpendëve, ndërsa veçohen: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), shqarthe i artë (*Martes martes*), shqiponja minjngrënëse (*Buteo buteo*), skifteri malor (*Falco biarmicus*), huti pyjor (*Bubo bubo*), pula e pyjeve (*Tetrastes bonasia*), thëllëza e gurit (*Alectoris graeca*) etj.

13) Lëndina e Shenjtë (KK Suharekë) - 14 ha

Lëndina e Shenjtë është rezervat i llojit stenoendemik bornmullera e dieckit (*Bornmuellera dieckii*). Në zonë dominon vegjetacioni barishtor, ndërsa pjesa qendrore e zonës është e mbuluar me pyje të e ahut dhe rrobullit. Nga llojet e tjera të rralla që janë të pranishme në këtë zonë veçohen: dredhaku (*Pinus mugo*), sarusha e sharrit (*Stachys scardica*), poligala e Doerflerit (*Polygala doerfleri*), gencianeza bullgare (*Gencianella bulgarica*), potentilla e australis (*Potentilla australis*), lëpjet e bukur (*Rumex pulcher*), sericë e gurit (*Alysum murale*), etj.

Vlerat turistike

Njëri ndër rolet më të rëndësishëm i Parkut nacional është vlera e tij turistike-rekreative. Atraksionet natyrore (flora dhe fauna e pasur, vegjetacionet pyjore dhe barishtore, rrjedhjet ujore dhe liqenet e shumtë, klima, peisazhet e bukura, terrenet për skijim dhe rekreacion) dhe pozita e gjeokomunikacionit japin mundësi që në këtë territor të zhvillohen të tri mënyrat themelore të turizmit (turizmi stacionar, uikendo-piknik dhe transit) gjatë gjithë vitit. Kushtet e volitshme natyrore mundësojnë zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit stacionar siç janë: turizmi sportiv-dimëror, turizmi veror, turizmi shëndetësor, turizmi i gjuetisë, turizmi rural, pushimi dhe rekreacioni i punëtorëve, përgatitjet fizike dhe psikike të ekipeve sportive, ekskursionet edukativo-arsimore, simpoziumet dhe manifestimet, hulumtimet shkencore, alpinizëm etj. Zhvillimi i turizmit në PN duhet të përputhet me kriteret e caktuara të mbrojtjes dhe ruajtjes së veçorive burimore të natyrës.

Zonat më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit në territorin e Parkut nacional janë:

- Brezovica (KK Stërpcë) - zona për zhvillimin e turizmit dimëroro-sportiv dhe uikendo piknik. Brezovica është e vetmja qender turistike e rregulluar dhe në funksion në territorin e Parkut nacional.
- Prevala (KK Prizren) - zona për zhvillimin e turizmit stacionar gjatë stinave verore dhe dimërore, turizmit uikendo piknik dhe turizmit tranzitor.
- Guri i Zi (KK Prizren) - zona për zhvillimin e turizmit dimëroro-sportiv dhe uikendo-piknik.
- Ujrat e Gropuar (KK Prizren) - zona për zhvillimin e turizmit malor shëndetësor dhe uikendo-piknik.
- Gradac (KK Suharekë) - zona për zhvillimin e turizmit stacionar gjatë stinave verore dhe dimërore dhe turizmit uikendo-piknik.
- Kroni i Madh (KK Suharekë) - zona për zhvillimin e turizmit malor gjatë stinës verore dhe turizmit uikendo-piknik.
- Tëbanët e Dubravës (KK Kaçanik) -zona për zhvillimin e turizmit malor dhe uikendo-piknik.